



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT RAJONAL PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Vlera e pasurive kapitale të ministrisë ishte e mbi-vlerësuar për 250,000€ si rezultat i mos-shlyerjes së dy pagesave të regjistruara në kategorinë investim në vijim, pas përfundimit të projektit të bashkëfinancuar për komuna dhe regjistrimit të tij në regjistrin e pasurisë së komunës.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Zhvillimit Rajonal kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 Për projektet e subvencionuara nga skema e granteve për Programet e Zhvillimit Rajonal të Balancuar të vitit 2023 dhe 2024, në tri raste në vlerë të përbashkët prej 80,000€, kemi identifikuar mangësi në zbatimin e kriterit për krijim të vendeve të reja të punës nga ana e përfituesve.
- A2 Në dy raste të testuara të subvencionimit të Organizatave jo qeveritare (OJQ) në vlerë 8,020€ janë evidentuar mangësi që lidhen me dokumentimin dhe arsyetimin e shpenzimeve nga ana e OJQ-ve përfituese, si dhe me mungesën e monitorimit adekuat nga ana e ministrisë.
- C1 Vlera e avanceve të hapura dhe të pa-arsyetuara të ministrisë për vitin 2024 ishte 36,533€ si rezultat i mangësive në shfrytëzimin e kredit kartelave dhe mbylljes së tyre.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Zhvillimit Rajonal është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më shumë fokus janë menaxhimi i pasurisë ku kujdes më i shtuar duhet t'i kushtohet mbikëqyrjes së projekteve të bashkëfinancimit me komunat, bartjes së pronësisë me kohë pas përfundimit të tyre dhe pasqyrimin të gjendjes së saktë në regjistrin e pasurive. Po ashtu fusha që kërkojnë përmirësim janë edhe avancet/kartelat kreditore të pa mbyllura si dhe evitimi i mangësive në fushën e subvencioneve.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ishte funksionale përgjatë tërë vitit si rezultat i transferimit të përhershëm të Udhëheqësit të kësaj njësie në një organizatë tjetër buxhetore dhe mos arritjes së plotësisë të kësaj pozite përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

Ky raport ka rezultuar me 5 (pesë) rekomandime prej të cilave tri (3) rekomandime janë të reja, një (1) rekomandim është i përsëritur dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mangësi në menaxhimin e pasurive financiare

Gjetja Rregullorja MF-NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 12.3 përcakton se, në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimit nga ana e organizatës buxhetore, e cila e fiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë përkatëse, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e organizatës buxhetore pranuese dhe organizatës buxhetore bashkëfinancuese.

Regjistri i pasurive kapitale të ministrisë ishte mbi-vlerësuar për 250,000€ si rezultat i mos mbylljes së projektit të bashkëfinancuar, pas përfundimit dhe regjistrimit të tij në regjistrin e pasurisë së komunës.

Dy pagesa në vlerë të përbashkët 250,000€ të ekzekutuara nga ministria sipas marrëveshjes së mirëkuptimit të nënshkruar në shkurt të vitit 2023, në mes të MZHR-së dhe Komunës së Lipjanit, ende figuronin si investim në vijim në regjistrin e pasurive, edhe pse projekti kishte përfunduar. Projekti i bashkëfinanciar, “Rehabilitimi i infrastrukturës në zonën e qendrës kulturore historike në fshatin Janjevë” kishte përfunduar në shtator të vitit 2024, dhe vlera totale e tij ishte regjistruar si pasuri në përdorim tek komuna përfituese. Megjithatë, ministria nuk kishte kryer mbylljen përkatëse të investimit dhe në regjistrin e pasurisë së ministrisë për vitin 2024 ky projekt vazhdon të figuroj si investim në vijim për pjesën e financuar ministria.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së komunikimit të mirëfilltë për progresin e projekteve të bashkëfinancuara dhe bartjes së pronësisë sipas rregullave. Po ashtu, mos-koordinimit të Departamentit për Zhvillimit Rajonal në kuadër të ministrisë si dhe menaxherëve të projekteve me personat përgjegjës në Komunë.

Ndikimi Shuma e financuar nga ministria e mbajtur në regjistrin e pasurisë si investim në vijim edhe pas përfundimit të projektit, ndikon në mbivlerësim të gjendjes së pasurive të ministrisë. Krahas kësaj, si rezultat i dyfishimit të vlerës së regjistruar për të njejtin projekt nga dy entitete, ka ndikim në mbivlerësimin e gjendjes së përgjithshme të pasurive në Raportin Vjetor Financiar të konsoliduar për vitin 2024.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë mekanizma dhe komunikim më efektiv në mes të palëve të përfshira në projektet me bashkëfinancim, në mënyrë që njoftimet të bëhen në kohë dhe bartja e pronësisë së pasurive të bëhet sipas rregullave në fuqi. Gjithashtu, të ndërmerren veprime për përditësimin dhe mbylljen e investimit në regjistrin e pasurive, në përputhje me dokumentacionin mbështetës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Mos zbatimi i kriterit për krijimin e vendeve të reja të punës

Gjetja Udhëzuesit për aplikantët e granteve për “Programin e Zhvillimit Rajonal të Balancuar” (PZhRB) për vitin 2023 dhe vitin 2024, përkatësisht pika 1.2 dhe 1.3 parasheh që një nga synimet kryesore të skemës së granteve dhe thirrjes për propozime është “Zvogëlimi i pa-punësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë”. Në formularët për aplikim përfituesit potencial të granteve obligohen të deklarojnë numrin e planifikuar të punëtorëve të rinjë që do t’i punësojnë me rastin e përfitimit të grantit si dhe përmbushja e këtij kushti konfirmohet në raportin e monitorimit para kryerjes së pagesës së dytë (përfundimtare) të grantit. Po ashtu në kontratat e nënshkruara me ministrinë, sipas Nenit 7 përfituesi është i obliguar t’i ofroj qasje të plotë për periudhën dy vjeçare çdo kontrolli të bërë nga MZHR që ndërlidhet me investimin e bërë duke përfshirë edhe të dhënat mbi punëtorët.

Për projektet e subvencionuara nga skema e granteve për PZhRB për vitin 2023 dhe 2024, kemi vërejtur se në tre raste për projekte në vlerë të përbashkët të grantit të përfituar prej 80,000€, nuk ishin deklaruar tatimet në paga dhe kontributet pensionale të punëtorëve për të cilët kishte deklaruar përfituesi që do t’i punësoj në rast të pranimit të grantit. Në dy raste punëtorët nuk figuronin fare të regjistruar/deklaruar nga punëdhënësi ndërsa në një rast kontributet ishin paguar vetëm për tre muaj.

Kjo kishte ndodhur për shkak se ministria nuk kishte vendosur politika të zbatueshme për monitorimin dhe mbikëqyrjen e plotësimit të këtij kriteri në vazhdimësi gjatë realizimit të projektit.

Ndikimi Mos-monitorimi i vazhdueshëm i përmbushjes së kriterit për krijim të vendeve të reja të punës, rrit rrezikun që granti i dhënë të mos e arrij qëllimin e synuar të punësimit, që është edhe një nga synimet kryesore të kësaj skeme të granteve.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj se janë përcaktuar politika monitoruese efektive në mënyrë që kriteret e vendosura për përfituesit të zbatohen për tu arritur qëllimi i synuar i përkrahjes së bizneseve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në dokumentimin dhe monitorimin e projekteve të subvencionuara për OJQ-të**Gjetja**

Sipas nenit 5 të kontratës së nënshkruar në mes të MZHR-së dhe OJQ-së përfituese të subvencionit, përcaktohet se "Ofruesi i mbështetjes financiare rezervon të drejtën për monitorimin dhe vlerësimin e ekzekutimit të projektit, duke përfshirë shqyrtim të financave dhe shpenzimeve të vazhdueshme në çdo kohë gjatë projektit dhe për një periudhë prej 1 viti pas përfundimit të projektit. Sipas nenit 9, parashihet se nëse ofruesi i mbështetjes financiare përcakton se përfituesi është duke i përdorur në mënyrë të papërshtatshme fondet e mbështetjes financiare për implementimin e projektit sipas kushteve të kësaj kontrate, ose ka dështuar të zbatojë projektin brenda afatit të kontraktuar, ose nuk ka paraqitur raportet e duhura në kohë dhe me përmbajtjen e përcaktuar në nenin 4 të kontratës, ose nuk i ka lejuar ofruesit të mbështetjes financiare mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve sipas nenit 5 dhe 6 të kontratës, pagesat e mëtejshme do të pezullohen, dhe përfituesi është i detyruar të kthej mjetet e shpenzuara në mënyrë të papërshtatshme dhe mjetet ende të pashpenzuara, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim për kthimin e mjeteve nga ofruesi i mbështetjes financiare.

Në kuadër të "Thirrjes publike për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar", në dy raste të testuara në vlerë të përbashkët prej 8,020€ janë evidentuar mangësi që lidhen me dokumentimin dhe arsyetimin e shpenzimeve nga ana e OJQ-ve përfituese, si dhe me mungesën e monitorimit adekuat nga ana e ministrisë.

Mangësitë e evidentuara kryesisht kanë të bëjnë me mospërputhje të shpenzimeve me vendin dhe kohën e realizimit të aktiviteteve, mungesë transparence në shpenzimet për ushqim dhe pije si dhe mungesë informacioni konkret në raportet narrative dhe ato të monitorimit lidhur me aktivitetet e zhvilluara. Po ashtu në raportet e monitorimit të lëshuara nga ministria, në të dy rastet periudha e raportimit nuk përputhet me periudhën e financimit dhe realizimit të aktiviteteve.

Mangësitë e identifikuar në të dy rastet tregojnë për një nivel të pamjaftueshëm të monitorimit nga ana e ministrisë dhe për mungesë të dokumentacionit të besueshëm dhe transparent nga ana e OJQ-ve përfituese.

Ndikimi

Këto mangësi mund të ndikojnë në keqmenaxhim të fondeve publike dhe në besueshmërinë e procesit të subvencionimit, si dhe në efektivitetin e përdorimit të fondeve të ndara për zhvillim socio-ekonomik rajonal.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të siguroj mekanizma më efikas të kontrollit për të bërë një monitorim më të rregullt dhe më të kujdesshëm të projekteve që financohen. Gjithashtu, është e domosdoshme që raportet e monitorimit në terren të hartohen në kohë të duhur dhe të përputhen me periudhat reale të zbatimit të projekteve të subvencionuara si dhe çdo aktivitet i raportuar të jetë i dokumentuar me dëshmi të qarta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Avance të hapura dhe mangësi në shfrytëzimin e kredit kartelave**Gjetja**

Rregullorja nr. 02/2018 për përdorim të kartelës kreditore për udhëtime zyrtare, përkatësisht neni 9.1 përcakton: Organizata buxhetore pranon nga kontraktori raport për secilin mbajtës të kartelës kreditore, jo më vonë se dita e pestë (5) e çdo muaji, për muajin paraprak, kurse pagesat bëhen deri më ditën e dhjetë (10) të çdo muaji. Pas këtij afati organizata buxhetore nuk regjistron dhe realizon pagesa për obligimet e shpenzimeve me kartelë kreditore, të cilat regjistrohen dhe realizohen nga Thesari. Po ashtu, neni 10.1 i kësaj rregullore përcakton: Në rastet kur organizata buxhetore nuk i kryen pagesat në afatin e caktuar, sipas kësaj Rregulloreje, Thesari bën pagesën nga buxheti i organizatës buxhetore te kontraktori, jo më vonë se data pesëmbëdhjetë (15) e çdo muaji ose sipas afatit të mëhershëm përcaktuar në kontratën me kontraktorin për këto shërbime.

Në Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2024, MZHR ka raportuar avance të hapura dhe të pa-arsyetuara në vlerë 36,533€, si më poshtë:

- Mjetet prej 33,683€ kanë të bëjnë me tërheqje nga kredit kartela. Prej tyre, obligimi prej 29,497€, i cili figuron në SIMFK, është i mbi-vlerësuar si rezultat i mos-marrëveshjeve në mes të Thesarit dhe sistemit bankar për shlyrje të obligimeve. Ministria ishte në komunikim të vazhdueshëm me Thesar për të rregulluar këtë çështje. Ndërsa, mjetet prej 4,186€ ishin obligime sa i përket tërheqjeve me kredit kartelë gjatë vitit 2023 dhe 2024 për qëllime jo zyrtare nga ana e zëvendës ministrit dhe mos-kthim i mjeteve brenda afatit të paraparë ligjor. Ministria në janar të vitit 2025 kishte marrë vendim për ndalesë në pagë ndaj zyrtarit përgjegjës me qëllim të përmbushjes së detyrimit të krijuar nga kredit kartela; si dhe
- Mjetet prej 415€ janë avance të hapura për udhëtime zyrtare jashtë vendit si dhe 2,355€ janë bilanc i bartur nga viti 2023 i pa definuar nga Thesari.

Mos arsyetimi dhe mos kthimi i mjeteve brenda afatit ligjor, si dhe përdorimi i kartelave kreditore për qëllime jozyrtare, ka ardhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme efektive dhe neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës. Ndërsa gjendja e mbivlerësuar e avanceve të hapura është rezultat i komunikimit joefektiv ndërmjet ministrisë, Thesarit dhe sistemit bankar për harmonizimin e të dhënave dhe pasqyrimin e saktë të obligimeve.

Ndikimi

Kjo situatë rrit rrezikun e menaxhimit jo të duhur të fondeve publike. Gjithashtu, pasqyrimi i pasaktë i gjendjes së avanceve të hapura ndikon në mos-informim të drejtë të palëve të interesuara.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të siguroj kontrolle efektive për të siguruar që të gjitha avanset/kartelat kreditore monitorohen dhe mbyllen brenda afateve të caktuara ligjore. Po ashtu, duhet të forcohet komunikimi dhe bashkëpunimi me Thesar dhe me akterët tjerë për të harmonizuar të dhënat dhe për të pasqyruar drejtë gjendjen e avanceve të hapura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm në MZHR ishte i themeluar me Statutin e Njesisë së Auditimit (NJAB). Kjo njësi ka operuar me një auditor në pozitën e udhëheqësit të njësisë. NJAB kishte përgatitur planin vjetor të auditimit për vitin 2024 me të cilin kishte planifikuar kryerjen e katër (4) auditimeve. Nga katër (4) auditime të planifikuara ka arritur të realizoj vetëm dy (2) auditime, pasi nga gushti i vitit 2024 kjo njësi nuk ishte funksionale.

Çështja A3 - Funksionimi jo i plotë i NJAB-së

Gjetja

Rregullore QRK-NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, Neni 1 përcakton kriteret për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik.

MZHR nuk kishte funksionale NJAB-në nga muaji gusht i vitit 2024. Me marrëveshje për transferim të përhershëm të nëpunësit civil, Udhëheqësja e NJAB-së në MZHR ishte transferuar në një organizatë tjetër buxhetore. Pas lirimit të pozitës ministria kishte bërë përpjekje për të rekrutuar një auditor të ri por deri në përfundim të auditimit tonë, pozita nuk ishte plotësuar. Si rezultat, nuk është përmbushur plani në tërësi si dhe nuk ishte kryer raportimi i rregullt vjetor në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NjQHAB).

Mosplotësimi i pozitës së auditorit të brendshëm ka ndodhur për shkak të dështimit të procesit të rekrutimit në mungesë të kandidatëve të kualifikuar si dhe vonesave të shkaktuara në proces si pasojë e ankesave të aplikantëve. Megjithatë, ministria nuk kishte ndërmarrë masa për gjetjen e zgjidhjeve alternative të përkohëshme për mbulim të punës së auditimit të brendshëm si element i rëndësishëm i sistemit të brendshëm të kontrollit.

Ndikimi

Mosfunksionimi i NJAB-së ndikon në mos sigurimin e mbikëqyrjes efektive mbi funksionet financiare dhe administrative të ministrisë, si dhe zvogëlon transparencën dhe nivelin e llogaridhënies institucionale.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të ndërmerr masa për gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme për funksionalizimin e njësisë së auditimit të brendshëm. Në rast të dështimit të procedurave të rregullta të rekrutimit, të shqyrtohen mundësi alternative ose për transferim të përkohshëm të auditorit të brendshëm nga organizatat tjera buxhetore, për shkak të rëndësisë që ka ky funksion për ministrinë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	6,889,574	5,824,579	5,642,744	4,919,707	5,484,703
Grante Qeveritare - Buxheti	6,889,574	5,824,579	5,642,744	4,919,707	5,484,703

Buxheti final i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal ishte më i ulët se buxheti fillestar për 1,064,995€. Ky ndryshim i buxhetit ishte rezultat i vendimit të Qeverisë për ndarje dhe vendimeve për kursime në fund të vitit. Shkalla e realizimit të buxhetit final është 97%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	6,889,574	5,824,579	5,642,744	4,919,707	5,484,703
Pagat dhe mëditjet	603,337	556,885	556,885	480,258	365,417
Mallrat dhe shërbimet	274,877	274,877	224,354	213,126	185,849
Komunalitë	11,360	1,360	992	946	1,451
Subvencionet dhe transferet	2,000,000	2,000,000	1,976,827	2,056,012	3,509,326
Investimet Kapitale	4,000,000	2,991,457	2,883,686	2,169,366	1,422,661

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 46,452€. Ky zvogëlim ishte rezultat i vendimit Qeveritar për kursime në fund të vitit. Shpenzimi në këtë kategori ishte 100% e buxhetit final;


Buxheti fillestar dhe final për mallra dhe shërbime ishte i njëjtë dhe nuk kishte ndryshime. Shkalla e realizimit të buxhetit tek kjo kategori ishte 82%.

Buxheti final për shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 10,000€ si rezultat i vendimit qeveritar për kursime. Shkalla e realizimit të buxhetit ishte 73% si rezultat i reduktimit të shpenzimeve të ministrisë në këtë linjë buxhetore.

Buxheti fillestar dhe final për subvencione dhe transfere ishte i njëjtë dhe nuk kishte ndryshime. Ky buxhet kryesisht është shfrytëzuar për zbatimin e projekteve të bashkëfinancimit sipas memorandumit të MZHR-së dhe CARITAS-it Zviceran (CaCH), si dhe mbështetje e sektorit privat përmes skemës së granteve “Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar”. Shkalla e realizimit të buxhetit në këtë kategori ishte 99%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,008,543€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimit të Qeverisë në fund të vitit për ndarje buxhetore në vlerë 220,000€ dhe kursime në vlerë 1,228,543€. Shkalla e realizimit të buxhetit në këtë kategori ishte 96% dhe këto shpenzime kryesisht realizohen sipas Programit për Zhvillim Rajonal në bashkëfinancim me komunat.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga MZHR në vitin 2024 ishin në vlerë 10,000€. Ato kanë të bëjnë me konfiskimin e garancioneve bankare të përfituesve që nuk kanë arritur të implementojnë projektin e tyre konform marrëveshjes me MZHR-në.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	19,732	19,732	10,000	14,195	7,500
Të hyrat jo tatimore	19,732	19,732			
Të hyrat tjera	0	0	10,000	14,195	7,500

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të MZhR-së ka rezultuar në tre (3) rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna si dhe janë dorëzuar raportet periodike për progresin në zbatimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një (1) rekomandim ishte zbatuar, një (1) ishte zbatuar pjesërisht si dhe një (1) rekomandim nuk ishte zbatuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se janë përcaktuar politika monitoruese efektive në mënyrë që kriteret e vendosura për përfituesit të zbatohen për tu arritur qëllimi i synuar i përkrahjes së bizneseve.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste ku nuk ishin kryer pagesa të rregullta të obligimeve tatimore për punëtorët e rinj të deklaruar nga përfituesit e granteve.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se në bashkëpunim me MFTP do të gjej një zgjidhje të qëndrueshme lidhur me plotësimin e nevojave të ministrisë për personel shtesë, kështu pozitat e rregullta të punës të përfshihen në planin e rekrutimeve, dhe të sigurohet rekrutimi i personelit të nevojshëm përmes procedurave të rekrutimit në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë.	Nuk kemi hasur në raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
3.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministri duhet të siguroj kontrole efektive për të siguruar që të gjitha avanset/kartelat kreditore monitorohen dhe mbyllen brenda afateve të caktuara ligjore. Po ashtu, duhet të sigurohet që përdorimi i kartelave kreditore nga ana e zyrtarëve përgjegjës të bëhet vetëm për qëllime zyrtare dhe mjetet e pa arsyetuara duhet të kthehen.	Edhe këtë vit kishte avance të hapura dhe shfytëzim të kredit kartelës për qëllime jo zyrtare dhe mos mbyllje e tyre me kohë. Ministria kishte marrë masa në aplikimin e ndalesave në pagë për zyrtarët që nuk i kanë kthyer mjetet e pa arsyetuara.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Fjolla Bakalli Sadiku, Udhëheqëse e ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Valbona Tolaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mangësi në menaxhimin e pasurive financiare	<p>Fillimisht nuk pajtohemi me kualifikimin e Draft Raportit meqenëse kualifikimi ka arrdhur si rezultat i të gjeturës së parë, e gjetur e cila nuk është në përgjegjshinë e Ministrisë dhe në vijim japim sqarimet për këtë të gjetur dhe për të gjeturat tjera.</p> <p>Duke u bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit të cilat lidhen ndërmjet MZHR-së dhe Komunave e kemi të rregulluar çështjen e bartjes së pasurisë si dhe përgjegjësitë për bartjen dhe përcjelljen e dokumentacionit përkatës lidhur me pasuritë. Në Marrëveshjen e Mirëkuptimit tek neni 4 Obligimet e Komunës, specifikisht pika 13 thotë “Komuna obligohet që pas përfundimit të projektit, obligimeve kontraktuale të dërgoj në MZHR dokumentacionin përkatës me të cilin dëshmohet përmbyllja e projektit”, andaj duke u nisur nga ky nen dhe kjo pikë Komuna obligohet që pas realizimit të pranim teknik të dërgojë në formë elektronike ose fizike dokumentet për pranim teknik në MZHR siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa nga OE për pranim teknik; - Vendimi nga ZKA për formimin e komisionit për pranim teknik dhe raporti nga komisioni për pranim teknik; - Apo sikurse në rastin e Komunës së Lipjanit çertifikatën për pranim të përkohshëm teknik të punimeve. <p>Komuna e Lipjanit me datën 20.08.2024 ka dërguar email tek Udhëheqësja e prokurimit në MZHR dhe ka kërkuar pagesat të cilat ka</p>	<p>Sipas nenit 3.3 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit, e lidhur ndërmjet ministrisë dhe komunës përfituese, Ministria mban përgjegjësi për monitorimin e projektit në të gjitha fazat e tij, përfshirë zbatimin dhe përfundimin e projektit. Kjo dispozitë përbën një element thelbësor të marrëveshjes dhe nuk mund të lihet pa u adresuar gjatë procesit të mbikëqyrjes.</p> <p>Gjithashtu, neni 17.2 i Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) përcakton datën 30.07.2024 si afatin përfundimtar për përmbylljen e punimeve. Duke qenë se kjo kontratë ishte në posedim të Ministrisë, ekzistonte një pritshmëri legjitime që autoriteti bashkëfinancues të kishte ndjekur progresin e projektit dhe të ishte i informuar për përmbushjen e afateve kontraktuale.</p> <p>Për më tepër, komunikimi zyrtar nga Komuna, përmes email-it të datës 20.08.2024, ku theksohet se ishte në proces të ekzekutimit të faturës përfundimtare, sugjeron se projekti kishte hyrë në fazën përmbyllëse. Në këtë kontekst, mungesa e informimit të brendshëm për përfundimin e projektit për një periudhë prej afërsisht tetë muajsh, deri në momentin kur kjo u identifikua nga ekipi i auditimit, nënvizon nevojën për përmirësim të mekanizmave të monitorimit dhe koordinimit institucional.</p> <p>Roli mbikëqyrës i Ministrisë, siç</p>

	<p>realizuar MZHR për atë projekt mirëpo nuk ka cekur se ju nevojiten për pranim teknik vetëm për pagesë të situacionit dhe ky informacion për MZHR nuk na dëshmon që do të ndodh pranimi teknik. Ndërsa me datën 03.09.2024 Komuna Lipjanit ka regjistruar në SIMFK edhe pagesat tona dhe prap ka anshkaluar nenin 4 pikën 13 dhe nuk e ka njoftuar Ministrinë lidhur me certifikaten e përkohshme për pranim teknik të punimeve. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat konsiderojmë që kjo e gjetur duhet të jetë për Komunën e Lipjanit për faktin se MZHR nuk ka qenë e njoftuar dhe komuna nuk ju ka përmbajtur Marrëveshjes së Mirëkuptimit dhe nenit 4, pika 13 ku specifikohet se Komuna duhet të ofroj dokumentacionin për bartje të pasurisë.</p> <p>Bashkangjitur këtij komenti gjeni dëshminë që arsyeton komentin (Marrëveshja e Mirëkuptimit).</p> <p>Nuk pajtohem me këtë të gjetur.</p>	<p>përcaktohet në marrëveshjet përkatëse, kërkon zbatim proaktiv të përgjegjësive, në mënyrë që informacioni lidhur me progresin dhe përfundimin e projekteve të menaxhohet në mënyrë të vazhdueshme, të saktë dhe brenda afateve të përcaktuara.</p>
--	---	---

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRILIDJE DOKUMENTIT: 28.05.2025			
DATE/RECEVIM/PRILIDJE DOKUMENTIT: 28.05.2025			
Njësia Org. / Org. Unit	Shit. Klasif. / Klassif. Code	Nr. Prof. / Br. Prof.	Nr. Fajësive / Br. Stranica
03	47	809	6



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL - MINISTARSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ	
MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT	
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE	
DALËSE / IZLAZE / OUTGOING	
Nr./Br.No	434
Nr./q / Bshr./No.pq	
Data / Datum / Date	27.05.2025
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINE	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem pjesërisht** me gjetjet dhe rekomandimet dhe kam komente për përmbajtjen e Raportit; (në shtojcën e bashkangjitur gjeni komentet lidhur me përmbajtjen)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Besim Kamberaj,

Sekretar i Përgjithshëm në MZHR,

Data: 27 Maj 2025



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.